



Protokoll i Mbledhjes

Vendtakimi: Zyra e ZRrE-së, Salla e mbledhjeve

Data: 08 Nëntor 2005

Koha: 14:00 –16:00

Temat e Diskutuara: Prezantimi i dy Rregullave të Zyrës së Rregullatorit për Energji, “Draft-Kodit të Sjelljes dhe Etikës” dhe “Draft- Statutit të Zyrës së Rregullatorit për Energji”.

Prezent:

#	Emri Mbiemri	Institucioni	Tel:	E- mail:
1.	Merita Kostari	ZRrE	044 333 370	merita.kostari@eumik.org
2.	Nick Frydas	ZRrE	044 408 342	nick.frydas@eumik.org
3.	Nysret Avdiu	ZRrE	044 277 681	nysret.avdiu@eumik.org
4.	Theranda Beqiri	ZRrE	038/2040/148	theranda.beqiri@eumik.org
5.	Drita Haziri	ZRrE	038/2040/219	drita.haziri@eumik.org
6.	Rifat Blakaj	ZRrE	044 135 456	rifat.blakaj@eumik.org
7.	Sherife Avdyli	KEK	038/240245/232	sherife.avdyli@kek-energy.com
8.	Hysnije Rexhaj	ZRrE	044 257 214	hysnije.rexhaj@eumik.org
9.	Azem Kastrati	ZRrE	038 2040/221	azem.kastrati@eumik.org
10.	Gani Asllani	MEF	044 505 508	ganasllani@hotmail.com
11.	Neil Buch	Banka Botërore	044 120 045	nbush@orlbank.org
12.	Kostas Bakoyanis	Banka Botërore		kbakoyanis@orlbank.org
13.	Afrim ajvazi	ZRrE	044 220 442	afirm61@yahoo.com

Takimin e hapi **Z. Nick Frydas** duke njoftuar të pranishmit me qëllimin e Seancës së Dëgjimit në të cilën do të bëhet Prezantimi i dy Draft Rregullave të legjislationit sekondar të ZRrE-së, përgatitur dhe prezantuar nga Merita Kostari-Kryesuese e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim, si dhe anëtare e Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji. **Z. Frydas** shpjegoi se, “Draft-Kodi i Sjelljes dhe Etikës” është nxjerrë në bazë të Nenit 11. të Ligjit të Rregullatorit për Energji, dhe paraqet udhëzimet në lidhje me parimet etike dhe rregullat e sjelljes, të cilat do të udhëheqin si anëtarët e stafit po ashtu edhe anëtarët e Bordit të ZRrE-së. Pika e dytë ishte “Draft-Statuti i ZRrE-së i nxjerrë sipas Nenit 9.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, i cili përcakton strukturën e brendshme, organizimin, procedurat për seancat e Bordit, punësimin e stafit etj. Ai gjithashtu shpjegoi procedurën e përgatitjes së legjislationit sekondar që duhet të nxirret nga ZrE-ja.

Zjn.M.Kostari bëri prezantimin e këtyre drafteve duke shpjeguar që qëllimi i këtij prezantimi është që të merren komentet dhe sugjerime nga të pranishmit në këto dy draft rregulla.

Të dy këto drafte janë të publikuara për komente dhe mund ti gjeni në faqen zyrtare elektronike të ZRrE-së, si dhe u janë shpërndarë të gjithë pjesëmarrësve në fillim të prezantimit në të tri gjuhët zyrtare, në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

N. Frydas tha se këto Draft-Rregulla janë përgatitur nga Departamenti Ligjor dhe i Licencave me ndihmën e konsulentëve të huaj të cilët janë të financuar nga programi i USAID-it.

Ai nuk kishte ndonjë koment të veçantë pasi që konsideronte që të dy këto draft rregulla janë të përgatitura mirë dhe se janë tipike që shumë organizata i kanë. Komenti i vetëm nga ai për Kodin e Sjelljes dhe Etikës ishte në lidhje me fshehtësinë e informatave komerciale, dhe ai propozoi që ky rregull duhet të aprovohet nga Bordi në seancën e njëjtë kur të bëhet edhe aprovimi i Manualit të Operimeve dhe Rregullës së Konfidencialitetit (Fshehtësisë).

Z. Frydas gjithashtu shtroi pyetje në lidhje me çështjen që në qoftë se një anëtar i stafit humbë statusin e tij në ERO, a është përcaktuar se sa duhet të ruajnë informacionin që konsiderohet i fshehtë?

Merita Kostari në këtë pyetje u përgjigj që nuk është përcaktuar, pasi që kjo është për gjithmonë, nuk do të ketë limitim kohor në këtë rast.

Znj. Th. Beqiri lidhur me piken 4, fq. 4(draft Kodi i Sjelljes dhe i Etikës) propozoj që fjalia: "Përpara sesionit ose gjatë sesionit, Bordi mund të vendos të mbyllë një pjesë apo gjithë sesionin për publikun", duhet të përcaktoj se cilat sesione duhet të jenë të mbyllura e cilat jo?

Z. Asllani (MEF)-bëri pyetjen lidhur me fondet e ZRrE-së, nga do të sigurohen, dhe a ka ndonjë bashkëpunim në mes të ZRrE-së dhe Ministrisë së Minierave dhe Mineraleve?

Z. Frydas i përgjigjet kësaj pyetje duke thënë se të gjitha informatat për financimin e ZRrE-së janë në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë 2004/9 (që është shpallur në Qershor 2004 nga Asambleja e Kosovës), dhe është e qartë se pavarësia financiare e ZRrE-së nuk ka të bëjë me MEM-in e as me ndonjë organizatë qeveritare.

Znj. M.Kostari, vazhdoj duke u përgjigjur për Z. Asllani se ZrE-ja ka krahasuar draftin e tij me rregullatorët e tjerë në rajon dhe se rregullatorët e tjerë në Kosovë kanë kërkuar që të kenë draftin e ZrE-së si shembull për draftet e tyre ZrE-ja ka bashkëpunim të mirë edhe me të gjitha organizatat e tjera.

Z. Buch (BB)- pyeti se:

1. a ka dhe cilat janë institucionet tjera në Kosovë që kanë një Kod të Sjelljes dhe Etikës të ngjashëm me këtë të ZRrE-së dhe a është bërë krahasimi i Kodit të Sjelljes dhe Etikës së ZRrE-së, me Kodin e Sjelljes dhe Etikës të Rregullatorëve të ndryshëm në Kosovë, p.sh me Rregullatorin e Aviacioni Civil, Rregullatorin e Ujit dhe Mbeturinave etj.?

3. nëse një anëtar i stafit ndjen se nuk mund të shkoj tek udhëheqësi i tij për të biseduar për ndonjë problem në zyrë, apo për të treguar për ndonjë problem të tij ose ndonjë ankesë, cila do të jete procedura ?

Znj. M.Kostari u përgjigj në 2 pyetjet e para, duke thënë se, Rregullatorët e lartpërmendur nga Z.Buch , kanë kërkuar të marrin draft kodet e ZRrE-së si shembull për draftet e tyre, dhe

tha se mendon që në të ardhmen ky do të jetë edhe Kodi i Sjelljes dhe Etikës pothuajse i njëjti edhe për Rregullatorët tjerë.

Ndërsa për pyetjen tjetër, Kostari tha se këtë do ta marrim parasysh në Manualin e Operimit.

Pas prezantimit të Draftit të Statutit Komentin e parë e shtroj **Z. N. Avdiu** -Anëtar i Bordit ,në lidhje me Nenin 4 ku nuk është sqaruar si duhet bërë përdorimi dhe numri i vulave të ZRrE-së, dhe propozoj që duhet të ceket në mënyrë precize përdorimi dhe numri i tyre, si dhe autorizimi se kush to të jetë përgjegjës për përdorimin e tyre.

Komenti tjetër i tij ishte për Nenin 8, ai shprehu mendimin që duhet të jetë dhe një tjetër paragraf që do të ishte 8.4, pasi që ka emërime të ndryshme edhe të gjithë anëtarët e bordit janë të njëjtë të gjithë duhet të kenë të drejta në njëjta në qasjen e informatave.

Z. Asllani(MEF)- pyeti se a ka ZRrE-ja llogari bankare, dhe licencat a mbesin në buxhetin e Konsoliduar të Kosovës apo në KEK?

Znj.M.Kostari u përgjigj se, ZRrE-ja ende nuk ka llogari bankare, pasi që ende nuk është filluar me licencim dhe se njëherë duhet të aprovohet Rregulla për Licencim, pastaj do të bëhet hapja e xhirlogarisë dhe do të hapim një llogari bankare kur të fillojmë me dhënien e licencave, për këtë do të bashkëpunojnë edhe me MEF-in.

Z. Frydas gjithashtu propozoi që neni 21 i Draft Statutit mund të mos jetë i nevojshëm dhe mund të shkoj në Manualin e Operimeve(Doracakun e Punës së ZRrE-së).

Për artikullin 24 ai u shpreh se mendon që nuk është i nevojshëm pasi që është shpjeguar në nenin 13.5 por mund të bëhet pjesë e Nenit 30.